

REPUBLICA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE




NIPT.L11913019B

Tiranë, më 06.10.2017

Nr.716.Dosje/Nr.2523.Prot.

URDHËR

PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

**Drejtuar: Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB)****Për dajeni:** Kreditorit, Majlinda Hila**Adresa:** Rr. "Idriz Collaku" Tiranë

Debitorit, Nikolin Risilia

Adresa: Kompleksi "Lana Park", "Rruga e Kavajës", Tiranë

Pranë Shoqërisë së Përmbarrimit "**BAILIFF SERVICES-MATANI&CO**" sh.p.k, në referim të Titullit Ekzekutiv, Vendimi Nr.3659 date 16.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vënë në ekzekutim ky Titull, duke regjistruar në dosjen përmbarrimore Nr.716, datë 04.02.2013, kërkesën e kreditores **Majlinda Hila** ndaj debitorit **Nikolin Risilia**, ku është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit, vendimi Nr.11371 akti, date 24.12.2012 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Unë, **Arben Sh Matani**, me detyren e përmbarruesit gjyqësor privat, pasi studiova materialet e dosjes përmbarrimore **Nr.716, datë 04.02.2013, konstatoj se:**

Sipas Titullit Ekzekutiv, Vendimi nr. Nr.3659 dt.16.04.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, është percaktuar detyrimi i pales debitore Nikolin Risilia të paguaje detyrimin ushqimor për **femijen Kora Joy** në masën 30.000(tridhjetemije) leke në muaj. Ky detyrim fillon nga dita e ngritjes së padisë, date 09.05.2011.

Pas ezaurimit të afateve për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, përmbarruesi gjyqësor mori vendim për kalimin në ekzekutim të detyrueshëm. U vijua me procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar **Qendrës Kombëtare të Biznesit**, "Urdhër Për Vendosjen e Masës së Sekuestros Konservative" me Nr.716.Dosje/ Nr.850.Prot., datë 20.02.2013, i cili kërkon të vendosë sekuestro konservative mbi **50%** të aksioneve (kuotave) të shoqërisë "HYDRO&ENERGY" sh.p.k me NIPT K72227008T, në pronësi të debitorit **Nikolin Dhimitraq Risilia**, i dtl 19.02.1975 me qëllim ndalimin e tjetërsimit të tyre deri në ekzekutimin e plote të detyrimit. Urdhëri i sipërpermendur i përmbarruesit gjyqësor është konfirmuar nga institucioni juaj.

Në vijim, pala debitore **ka likujduar të gjitha detyrimet e prapambetura** (referuar këtu mandatpagesave bankare të depozituara pranë zyres tone përmbarrimore) në favor të pales kreditore. Në këto kushte, lind nevoja e lirimit/zhbllokimit nga masa e sekuestros konservative të pasurive të luajtshme të pales debitore.

Shpërfaqja sipër, referuar nenit 519 e vijues të K.Pr.Civile, nenit 32 pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. Heqjen e menjëhershme të masës së sekuestros konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr.716.Dosje/ Nr.850.Prot., datë 20.02.2013, mbi

- **50%** të aksioneve(kuotave) të shoqërisë "HYDRO&ENERGY" sh.p.k me NIPT K72227008T, në pronësi të debitorit **Nikolin Dhimitraq Risilia**, i datëlindjes 19.02.1975

2. Të njoftohem dhe informohem menjëherë në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana juaj.

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, ju vë në dijeni se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbartimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në (4 katër) kopje.

Përmbartues GJYQËSOR
Arben Sh Matani

